

## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT KONTRIBUTOR AKTIV NË HARTIMIN E STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE TË AUDITIMIT

nga Luljeta NANO<sup>1</sup> - Sekretare e Përgjithshme,  
botuar në gazetën “Telegraf”, më 11 maj 2015.



KLSH krahas implementimit të reformave institucionale, të cilat synojnë në shndërrimin e këtij institucioni në një institucion modern të Auditimit të Jashtëm të Sektorit Publik, aktualisht po luan një rol pro aktiv edhe me pjesëmarrjen dhe asistimin në aktivitetet e komunitetit të INTOSAI-t (Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit).

Institucionet Supreme të Auditimit kudo në botë përfaqësojnë një komponent mjaft të rëndësishëm të shteteve demokratike dhe luajnë një rol vital në përmirësimin e efektivitetit dhe eficiencës së sektorit publik.

E parë në këtë këndvështrim, paraqitet si një nevojë imediate tranzitimi i Institucionit të Kontrollit të Lartë drejt konsolidimit të tij si një institucion model, i cili udhëhiqet nga parimet dhe vlerat etike të integritetit, objektivitetit, pavarësisë e kompetencës profesionale në funksion të promovimit të transparencës, eficiencës, efektivitetit dhe llogaridhënies publike.

Mund të konfirmohet që KLSH pas një periudhe më shumë se tre vjeçare të një menaxhimi institucional i fokusuar kryesisht **në ngritjen** e kapaciteteve audituese tashmë ky institucion po shkon drejt tranzitimit duke synuar **forcimin** e kapaciteteve audituese.

Objektivat strategjike të KLSH-së, konsistojnë në ndërmarrjen e masave të nevojshme drejt progresit me qëllim që veprimtaria institucionale audituese të reflektojë kërkesat e BE-Acquis Communautaire drejt qasjes së shndërrimit në një institucion auditimi, i cili të jetë një nga aktorët kyç në arkitekturën e mbikëqyrjes së menaxhimit të financave publike.

Synimet progresiste të Kryetarit të KLSH-së nuk kufizohen vetëm në rrafshin kombëtar për modernizimin e institucionit në një linjë me standardet ndërkombëtare të auditimit por shkojnë dhe më tej duke synuar një rol proaktiv të institucionit edhe në nivel ndërkombëtar në komunitetin e INTOSAI-t.

Në përmbushje të këtij vizioni, KLSH shprehu vullnetin pozitiv për të qenë kontributore dhe pjesë aktive e projektit të rishikimit të Standardit Ndërkombëtar ISSAI 30 Kodi Etik i Institucioneve Supreme të Auditimit iniciativë e ndërmarrë nga Këshilli Mbikëqyrës i Komitetit të Standardeve Profesionale (PCS).

Kodi Etik i INTOSAI-t i cili daton që nga viti 1998 dhe ndryshimet globale në fushën e auditimit apo edhe të vlerave dhe parimeve etike të trupave audituese diktuan nevojën që Këshilli Mbikëqyrës i Komitetit të Standardeve Profesionale (PCS) në Qershor të vitit 2013 të vendoste rishikimin e ISSAI 30.

Faza e parë e projektit për rishikimin e këtij standardi ishte nisja e një vlerësimi nëse ISSAI 30 është i përshtatshëm referuar statusit të auditimit të sektorin publik në nivel global.

Projekti i rishikimit të ISSAI 30, filloi me një ekip përfaqësuesish të Institucioneve Supreme të Auditimit (mbi baza vullnetare) të Polonisë, Indonezisë, Portugalisë, të Anglisë dhe Amerikës, Kili, Shqipërisë Hungarisë, Zelandës së Re, Holandës si dhe përfaqësues të Federatës Ndërkombëtare të Llogarive.

Nga pikëpamja kontributive referuar dhe planit të veprimit për përmbushjen e objektivit për hartimin e Standardit të Kodit Etik të Institucioneve Supreme të Auditimit, përfaqësuesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe SAI-t të Kilit u ngarkuan me detyrën për hartimin e një prej vlerave të rëndësishme të etikës, të “Kompetencës profesionale”.

Në bashkëpunim me përfaqësuesit e Institucionit Suprem të Auditimit të Kilit profili i trajtimit të këtij parimi përbënte një risi pasi përfshinte për herë të parë një sërë elementesh të rinj të kërkesave të kompetencës profesionale si në nivel individual (stafi i SAI-t, auditues, ekspertë të angazhuar dhe struktura mbështetëse) dhe atë institucional (SAI).

Në dokumentin e hartuar nga përfaqësuesit e KLSH-së dhe të SAI-t të Kilit definicioni i parimit të qenurit “Kompetent” u prezantua në këndvështrimin e etikës kjo në reflektim edhe të zhvillimeve dhe sfidave të reja të Institucioneve Supreme të Auditimit në nivel global.

Një dimension i ri i trajtimit të vlerave etike në Standardin e ri që po hartohet është dhe përfshirja në kod edhe e rolit të lidërshiptit dhe

menaxhimit të lartë të Institucioneve Supreme të Auditimit konsideruar në optikën e rolit kyç që ka menaxhimi i SAI-t për miratimin dhe adaptimin e strategjive specifike dhe politikave për menaxhimin e etikës.

Menaxhimi i lartë në institucionet Supreme të Auditimit duhet të demonstrojë dhe veprojë në përputhje me parimet dhe vlerat etike si dhe të promovojë një kulturë etike në organizatë.

Në kërkesat në nivel institucional (SAI) janë konsideruar elementë të tillë si: Zhvillimi i mekanizmave të brendshme e të jashtme të komunikimit, si dhe të fleksibilitetit me synim efektivitetin e performancës institucionale, si dhe përmbushjen me sukses të pritshmërive të komunitetit të cilit SAI i shërben, taksapaguesve, publikut, Parlamentit dhe organeve ekzekutive.

Përveç sa më sipër ndër kërkesat parësore në nivel institucional është ekselenca, çka do të thotë që Institucionet Supreme të Auditimit duhet të fokusohen në marrjen e masave, të cilat synojnë në instalimin e politikave të menaxhimit të burimeve njerëzore për sigurimin e një stafi ekselent, si në termat e aftësive teknike profesionale, ashtu edhe në terma të vlerave etike dhe të integritetit.

Ndër kërkesat në nivel individual përmendim: të qenurit konkurrues, vetëmotivues, fleksibël, ruajtjen dhe zhvillimin e njohurive profesionale, etj.

Përcaktimi i Vlerës etike të “Kompetencës” me elementët e mësipërm dhe përfshirja e tyre në Standardin e ri ishte rrjedhojë dhe përçim i praktikave dhe eksperiencës së Kontrollit të Lartë të Shtetit në aspektin e menaxhimit institucional në këtë aspekt.

Boshti i filozofisë së menaxhimit të burimeve njerëzore në institucionin e KLSH-së është konsiderimi i tyre më shumë si një **aset** sesa një kosto institucionale.

Objektivi i KLSH-së është që të përmirësojë vazhdimisht performancën e tij, kjo mund të arrihet vetëm nëpërmjet një stafi i cili është kompetent, profesional i motivuar, i mirë menaxhuar si dhe që shpërblehet në mënyrë të drejtë.

Duke u mbështetur në udhëzimet dhe praktikat më të mira për ndërtimin dhe zhvillimin e kapaciteteve të Institucioneve Supreme të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka vijuar të investojë në zhvillimin e burimeve njerëzore.

Parimet dhe vlerat e SAI-t modern janë adoptuar dhe në vijimësi po aplikohen në çdo hap të veprimtarisë së KLSH-së. Për këtë KLSH do të vazhdojë të përsosë dhe më tej qasjen audituese, metodologjitë e punës dhe aftësojë kapacitetet audituese.

Tashmë KLSH po kalon në një fazë të re nga *ndërtimi*, në zhvillim të kapaciteteve dhe kjo kërkon ecje përpara, nën shembullin e më të përparuarit.

Mund të konfirmohet se eksperiencia e marrë dhe e përfutur në tre vitet e fundit në të gjitha aspektet e veprimtarisë audituese dhe menaxheriale institucionale ka bërë të mundur që KLSH të prezantohet me statusin e kontributorit aktiv dhe produktiv në pjesëmarrjet e aktiviteteve të organizuara në rrafshin internacional të komunitetit të INTOSAI-t.

---

<sup>1</sup>Shkrime të tjera të botuara nga Luljeta NANO për periudhën janar-qershor 2015:

- *KLSH partner i fuqishëm i financave publike.*  
(Botuar në gazetën "Telegraf", më 02 qershor 2015.)